


RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në FINANCË-BANKË në Shqip

Ofruar nga Universiteti Epoka

Eksperte e vlerësimit të jashtëm:
Prof.asoc. Dr. Etleva BAJRAMI



(Korrik 2017)


RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në FINANCË-BANKË në Shqip

Ofruar nga Universiteti Epoka

Eksperte e vlerësimit të jashtëm:
Prof.asoc. Dr. Etleva BAJRAMI



(Korrik 2017)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc në Financë-Bankë në Shqip

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	UNIVERSITETI EPOKA
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhëri/VKM I Licencimit	Shkresa MASH Nr. prot, 1983, datë 04.04.2011
	Urdhëri I Riorganizimit	UMASH Nr.312, date 27.07.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 260, datë 07.06.2011 (Bsc Finance/Banke (4 vite))*
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Financë – Bankë në Shqip
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë bachelor
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	UNIVERSITETI EPOKA
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli i 6 (gjashtë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	Viti akademik 2012-2013
17	Numri i studentëve për programin e studimit	103 studentë
	etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

*Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si; Bachelor në Financë bankë (me kohëzgjatje normale 4 vite). Është hera e parë që ky program studimi i nënshtohet procesit të akreditimit pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 312, date 27.07.2012.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Financë – Bankë (shqip)

- Me ane te shkreses se MAS me Nr 1983 prot, date 04.04.2011 (MAS konfirmon marrjen e njoftimit mbi ofrimin e ketij programi ne gjuhen shqipe), Kjo shkrese perben bazen ligjore per ofrimin e ketij programi ne gjuhen shqipe (sipas IAL).

- Me ane te Urdherit Nr. 260, date 07.06.2011 akreditohet programi **Bsc Finance/Banke (4 vite)** mbeshtetur ne VKA Nr. 176, date 30.05.2011, pozitiv me rekomandime.

- Me Urdher Nr. 312, date 27.07.2012 ky program studimi organizohet ne Bsc Finance-Banke (3 vite), mbeshtetur ne VKA Nr. 342, date 13.07.2012(vleresim pozitiv me sygjerim).

- Per programin e riorganizuar **Bsc Finance - Banke (3 vite)** nuk ka urdher akreditimi.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. As. Etleva Bajrami

Më 10.07.2017 me shkresë nr 020/11 prot, Universiteti Epoka paraqet pranë ASCAL komente në lidhje me draft RVJ e dërguar në këtë institucion më 23.06.2017. Eksperti I vlerësimit të jashtëm I pa me kujdes shpjegimet e Universiteti Epoka në lidhje me dy komente nga Draft RVJ. Ekspertja e vlerësimit pranon këto shpjegime dhe nuk bën ndryshime në Raportin përfundimtar. Në këtë mënyrë, ky raport merr formën e tij përfundimtare.

Gjatë vizitës në Institutcion Ekpserti i vlerësimit u shoqërua nga Specialistja e ASCAL, Znj Suela Kromidha

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË (BSC Finance- Banke, 4 vite)

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit Vendim Nr.176 datë; 30.05.2011 për programin e studimit „Financë/bankë“

- a. Të pasurohet literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe të bëhet një bashkërendim më i mirë ndërmjet njohurive nga eksperiencia botërore me ato që kanë të bëjnë me realitetin e ekonomisë shqiptare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Rekomandimi në lidhje me pasurimin e literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe të bëhet një bashkërendim më i mirë ndërmjet njohurive nga eksperiencia botërore me ato që kanë të bëjnë me realitetin e ekonomisë shqiptare, **nuk është plotësuar**. Në bibliotekë librat në gjuhën shqipe janë shumë pak. Biblioteka e këtij programi përbëhej nga një stendë e vetme e mbushur pak më shumë se gjysma.

Librat ishin të huaj dhe me nga një kopje, ndërsa librat shqiptarë ishin rreth 4-5 të tillë. Në gjuhën shqipe gjendeshin disa publikime periodike institucionesh.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit tëstudimit

Sipas RVB, misioni i Programit Bachelor në Financë-Bankë në Shqip është përgatitja e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat, publik dhe organizata jo-fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor. Programi i Financë-Bankës në Shqip synon ti përgjigjet nevojës së tregut për specialistë të aftë në fushën e financës dhe në sistemin bankar.

Objektivi kryesor i programit të Financë-Bankës në Shqip është të pajisë studentët me koncepteve themelore të fushës së financës dhe bankës. Nëpërmjet disiplinave që ofrohen studentët e këtij program marrin njohuritë e nevojshme për vendimmarrje financiare si në sektorin privat të bizneseve të ndryshme, ashtu edhe për vendimmarrje financiare në sektorin publik. Ofrimi i lëndëve bankare në këtë program ofron njohuritë e nevojshme për sfidat aktuale dhe të ardhshme të sektorit bankar.

Nëpërmjet lëndëve bashkëkohore studentët janë të përditësuar me risitë e fundit të fushës së financës dhe bankës. Në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet edhe punësimi i studentëve të diplomuar, pasi ata janë të aftë të përshtaten dhe të përgjigjen jo vetëm në tregun shqiptar me të gjithë sfidat që ai ofron por ky program ofron mundësinë etë diplomuarve të kualifikuar për të punuar edhe në vende të tjera ku ata mund të synojnë.

Sipas RVB, programi Bachelor në Financë-Bankë në Shqip ka disa objektiva si mundësimi i përfitimit të aftësive praktike për të kuptuar problemet ekonomike në sektorin bankar dhe financat për të ndërtuar një model dhe ta vënë në zbatim në mënyrë të plotë. Të kuptuarit thelbësor të koncepteve në lidhje me financat dhe bankat. Të kuptuarit thelbësor të koncepteve në lidhje me paratë dhe bankat. Të kuptuarit thelbësor të koncepteve rreth financave ndërkombëtare dhe bankave.

Ky program nëpërmjet disiplinave që ofron i përgjigjet zhvillimit të teknologjisë financiare dhe bankare nëpërmjet ofrimit të modeleve të ndryshme në lëndë si ekonometria financiare apo statistika, duke synuar jo vetëm në trajtim teorik të koncepteve financiare por edhe një analizë sasiore të tyre, duke nxjerrë në treg ekspertë të fushës së financës dhe bankës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe e tij.	studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Standarti I.1 është plotësuar. Programi BSC Financë-Bankës në Shqip me lëndët përkatëse në përbërje të tij mundëson kualifikimin e studentëve në fushën e financës dhe të sistemit bankar. Programi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Lëndët e fushës së financës dhe bankës ofrojnë dije që mundësojnë rritjen e aftësisë profesionale në këto fusha duke plotësuar nevojat e tregut me specialistë të kualifikuar të cilët do të ndihmojnë jo vetëm në plotësimin e nevojave të tregut në shërbim të publikut por do të nxisin zhvillimin e ekonomisë nëpërmjet aplikimit prej tyre të
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	

	njohurive ekonomike të marrë në lëndë të ndryshme të ofruara nga ky program.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Standardi I.2 është plotësuar. Për të realizuar strategjinë, institucioni synon të jetë koherent me zhvillimet e fundit botërore në sektorin e financës dhe bankës e cila duhet të jetë e kombinuar me nevojat e tregut shqiptar.</p> <p>Ky program këtë e realizon nëpërmjet kurrikulave që ofron dhe projekteve që zhvillon me studentët.</p> <p>Si një program i ciklit të parë, synohet krijimi i bazës formuese të një specialist finance apo banke edhe pse mund të ofroreshin edhe lëndë të tjera në këtë drejtim, kurrikulat e bëjnë të mundur krijimin e profesionistit me shprehje dhe aftësi të larta.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Standardi II.1 është plotësuar. Institucioni zhvillon vezhgim të tregut të punës, madje në funksion kërkesave të tregut të punës është hapur ky program studimi në gjuhën shqipe.</p> <p>Nga institucioni mbahet kontakt me studentët e diplomuar dhe mbi 80 përqind janë të punësuar apo vazhdojnë master apo phd.</p> <p>Numri i studentëve në këtë program krahasuar me programet e tjera që ofron ky fakultet është i ulët, megjithatë institucioni mendon rritje prej rreth 20 përqind të këtij numri në vitin e ardhshëm, konkretisht nga 39 që janë rregjistruar këtë vit synohen 50 studentë vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Numri i studentëve në këtë program studimi në të tre vitet është 103 dhe është konsiderueshëm i ulët krahasuar me IAL të tjera private që ofrojnë këtë program.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Standardi II.2 është plotësuar. Programi i studimit BSC Financë-Bankë shqip nuk ka elemente që të bien ndesh me interesat kombëtare. Interesat kombëtare ka vite që janë orientuar drejt zhvillimit ekonomik të vendit dhe përgatitja e specialistëve të kualifikuar në fushën e financës dhe bankës plotëson interesat kombëtare. Institucioni zhvillon aktivitete në raste festash me klubin e artit, sportit, etj.</p> <p>Studentët të cilët studiojnë në këtë program dhe vazhdojnë studimet e mëtejshme në universitete të huaja janë ambasadorët e përhapjes së vlerave dhe kulturës shqiptare.</p>

Konkluzione të GVJ:

Institucioni e ka plotësuar këtë standart. Program i studimit BSC FINANCE-BANKE shqip është i kompozuar në përputhje me misionin, qëllimin dhe strategjinë e institucionit në lidhje me përgatitjen e specialistëve të kualifikuar në fushat e financës dhe bankës. Strategjia e institucionit është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit ekonomik duke nxjerrë çdo vit specialistë në fusha kyçe të ekonomisë sic janë financat e biznesit që është edhe qeliza e zhvillimit të ekonomisë dhe në sistemin bankar që përbën edhe pjesën më të rëndësishme të sistemit financiar shqiptar. Nëpërmjet studimeve të tregut dhe ndjekjes së zhvillimit të karrierës së studentëve pas diplomimit në nivelin e parë institucioni është më pranë si nevojave të tregut të punës edhe të studentëve të diplomuar aty.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Universiteti "Epoka" ka dy fakultete: Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative si dhe Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Fakulteti është njësi kryesore e Universitetit "Epoka" i cili bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të cilave përfitohet diplomë. Përgjegjës për programin e studimit Financë- Bankë në Shqip është Departamenti i Financë-Bankës në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative

Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative janë: dekani, zëvendëskani, kancelari, Bordi i Fakultetit dhe Bordi Administrativ të Fakultetit.

Bordi i Administrimit të Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit.

Kancelari i fakultetit ka detyrën e raportuesit në mbledhjet e Bordit të Administrimit të Fakultetit.

Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Gjatë vizitës në institucion dhe gjatë takimeve me strukturat e fakultetit na u cilësua se hapja, shkrirja ose mbyllja e departamenteve në Universitetin "Epoka" bëhet me propozim të Senatit dhe me miratim të Këshillit të Lartë. Organizimi i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative në Universitetin "Epoka" është si më poshtë:

- Departamenti i Ekonomiksit;
- Departamenti i Financë-Bankës;
- Departamenti i Administrimit Biznesit;
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë i njësisë bazë mësimore-kërkimore. Gjatë vizitës në institucion dhe gjatë takimeve me strukturat e fakultetit na u cilësua Përgjegjësi i Departamentit zgjidhet nga Dekani mes anëtarëve të brendshëm të stafit akademik të Departamentit, miratohet nga Rektori dhe emërohet me vendim të Këshillit të Lartë për një periudhëkatërvjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Përgjegjësi i Departamentit është përgjegjës për veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në çdo nivel të departamentit dhe për drejtimin e rregullt dhe efikas të çdo aktiviteti brenda tij.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Në programin e studimit BSC Finance-Banke shqip, japin mësim 9 pedagogë të brendshëm dhe 10 të jashtëm, me raportin 47.3% të brendshëm.

Programi i studimit BSC Financë-Bankë shqip ndiqet aktualisht në të tre vitet nga 103 studentë, por departamenti synon rritje të numrit të studentëve në këtë program studimi. Nisur nga sa më sipër Departamenti i Financë – Bankës duhet të punësojë pedagogë të brendshëm për të rritur cilësinë e mësimdhënies, si dhe disponibilitetin e pedagogëve për të qenë sa më pranë studentëve për rritjen dhe nxitjen e kërkimit shkencor të tyre.

Përsa i përket gradave janë 2 PAE dhe 3 PAK me grada nga 19 pedagogë gjithsej që japin mësim në këtë program studimi që përbëjnë 26 përqind të stafit. Megjithatë stafi i jashtëm nuk është i qëndrueshëm gjë që nxjerr nevojën e stafit të brendshëm me grada. Nëse nisemi nga gjinia 9 prej 19 pedagogëve janë femra pra 47.3 përqind.

Stafi i brendshëm është staf relativisht i ri dhe si i tillë ka ambicie personale profesionale duke ndjekur trajnime apo mund të synojë lëvizje në ndonjë institucion tjetër, megjithatë 80 përqind e stafit është stabël. Stafi është i motivuar për kërkim shkencor dhe institucioni i mbështet ata duke mbuluar një pjesë të kostove gjatë kërkimeve shkencore për doktoraturë, si dhe për botime në revista shkencore. Kontratat e punës përmbajnë elementet e nevojshme të të dretave dhe detyrimeve të stafit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Standardi III.1 është plotësuar pjesërisht. Për rekrutimin e stafit akademik efektiv ndiqen procedurat e mëposhtme: departamentet dhe fakultetet përcaktojnë nevojat për staf të ri. Këto nevoja pasqyrohen në njoftimet e formave të ndryshme nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si në Web të Univeritetit, Shërbimin kombëtar të punësimit, etj.</p> <p>Kandidatët e mundshëm paraqesin pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore një dosje me jetëshkrimin në gjuhën angleze, gradat/titujt dhe kualifikimet e tyre. Zyra e Burimeve Njerëzore ia transmeton këto dokumenta Fakultetit përkatës ku më pas Bordi Administrativ zgjedh një komision prej tre akademikësh për shqyrtimin e kandidatëve.</p> <p>Kandidatët iu përgjigjen pyetjeve të këtij komisioni si dhe zhvillojnë prezantime të ndryshme në varësi të kërkesave të komisionit. Raporti për kandidatët e shqyrtuar i transmetohet Bordit Administrativ të Fakultetit i cili nga ana e tij merr vendimet për secilin kandidat gjithmonë duke u bazuar në të dhënat e komisionit të sipërpërmendur. Nëse</p>

	<p>merret vendimi për punësimin e një kandidati të caktuar, ky vendim i shkon Bordit Administrativ të Universitetit. Bordi Administrativ i Universitetit pasi e shqyrton vendimin, ia transmeton atë Këshillit të Lartë të Universitetit i cili jep vendimin përfundimtar. Pas vendimit përfundimtar nga ana e Këshillit të Lartë të Universitetit, kandidati plotëson dokumentat e kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe nënshkruan kontratën e tij pas deklarimit në organet tatimore.</p> <p>Në programin e studimit BSC Financë-Bankë shqip, japin mësim 9 pedagogë të brendshëm dhe 10 të jashtëm, me raportin 47.3% të brendshëm. Përsa i përket ngarkesës së orëve pedagogët efektiv apo të brendshëm, nisur nga planet mësimore të dorëzuara nga institucioni rezulton që ata mbulojnë rreth 46% e orëve në auditor, dhe 48% të orëve totale.</p> <p>Vlerësimi i stafit akademik kryhet nëpërmjet pyetësorëve drejtuar studentëve. Pyetësorët plotësohen nga studentët në cdo fund semestri. Vlerësimi i stafit realizohet edhe nëpërmjet pjesëmarrjeve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, publikimet shkencore në revista më factor impakti apo jo.</p> <p>Forma më e përhapur e njoftimeve për vende të lira pune pranë Universitetit “Epoka” është nëpërmjet publikimit të këtyre njoftimeve në faqen e internetit të Zyrës së Burimeve Njerëzore nën faqen e internetit të vetë Universitetit “Epoka”. Gjithashtu bashkëpunohet me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të Tiranës për vende pune të lira pranë Universitetit “Epoka”.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor, ose titullin akademik “Docent,.</p>	<p>Standardi III.2 është plotësuar. Zyra e Burimeve Njerëzore të Universitetit (EIS) mban të dhënat e të gjithë stafit akademik duke filluar nga ato personale si datëlindje, vendlindje, arsimimi gjithashtu duke hedhur në sistem edhe detyrat e ndryshme që stafi akademik mban pranë Universitetit “Epoka”, lejet që stafi akademik merr gjatë vitit akademik, lejen e qendrimit të stafit të huaj si dhe dokumenta të tjera të nevojshme. Universiteti “Epoka” disponon një listë të plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ të të gjithë institucionit për secilin semestër në zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore pranë Universitetit Epoka, publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik në faqen zyrtare: hr.epoka.edu.al</p> <p>Titullarët e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë shqip kanë gradën shkencore “Doktor” ose kanë përfunduar</p>

	<p>programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/Master i Arteve të Bukura ose programe të barasvlefshme me to dhe njëkohësisht.</p> <p>Një pedagoge e brendshme vijon studimet e Doktoratës (e dhënë e rezultuar nga CV dhe intervista).</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Standardi III.3 është plotësuar. Për mbarëvajtjen e mësimit angazhohen asistentët kërkimorë si personel ndihmës kërkimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëpërdorimin e ambienteve laboratorike që ndodhen në mjediset shkollore. Në programin Bachelor në Financë-Bankë në Shqip laboratorët përdoren vetëm gjatë zhvillimit të lëndës së “Ekonometrisë Financiare”.</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ angazhohet maksimalisht për mbarëvajtjen e mësimit, laboratorëve dhe cdo elementë ndihmës në përmbushjen e objektivave të programit Bachelor në Financë-Bankë në Shqip.</p> <p>Studentët në programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë në Shqip nuk kanë detyrim kryerjen e praktikës profesionale.</p> <p>Stafi akademik udhëheq studentët në tezat përfundimtare, gjatë punimeve shkencore nëse studentët marrin pjesë në konferenca. Stafi akademik i nxit studentët të realizojnë punime në bashkëpunim me ta.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Standardi III.4 është plotësuar. Universiteti “EPOKA” në kuadër të statutit të tij dhe në kuadër të standarteve të ISO-s organizon në mënyrë të vazhdueshme për stafin e tij trajnime në fusha të ndryshme. Trajnimet kryhen kryesisht në fusha konkrete ku stafi ka nevojë për mbarëvajtjen e punëve të ndryshme. Trajnime të ndryshme janë kryer në fusha si Classroom Technologies, Moodle, Turnitin, Sistemin EIS, trajnim mbi mbrojtjen dhe evakuimin në rast zjarri, trajnim mbi shkresat e ndryshme të përdorura në Universitetin “Epoka” si dhe trajnime orientuese për stafin me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme.</p> <p>Universiteti Epoka disponon bazën e të dhënave të programeve të studimeve të ofruara.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Për rekrutimin e stafit akademik efektiv ndiqen procedurat e mëposhtme: departamentet dhe fakultetet përcaktojnë nevojat për staf të ri. Këto nevoja pasqyrohen në njoftimet e formave të ndryshme nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si në Web të Universitetit, Shërbimin kombëtar të punësimit, etj..</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore pranë Universitetit Epoka, publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik në faqen zyrtare: hr.epoka.edu.al</p> <p>Në programin e studimit BSC Financë-Bankë shqip, japin mësim 9 pedagogë të brendshëm dhe 10 të jashtëm, me raportin 47.3% të brendshëm. Përsa i përket ngarkesës së orëve</p>	

pedagogët efektiv apo të brendshëm, nisur nga planet mësimore të dorëzuara nga institucioni rezulton që ata mbulojnë rreth 46% e orëve në auditor, dhe 48% të orëve totale. Titullarët e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë shqip kanë gradën shkencore “Doktor” ose kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/ Master i Arteve të Bukura ose programe të barasvlefshme me to. Stafi akademik dhe administrativ angazhohet maksimalisht për mbarëvajtjen e mësimin, laboratorëve dhe cdo elementë ndihmës në përmbushjen e objektivave të programit Bachelor në Financë-Bankë në Shqip. Studentët në programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë në Shqip nuk kanë detyrim kryerjen e praktikës profesionale. Universiteti këshillon dhe nxit studentët për praktikë gjatë verës pranë bizneseve të ndryshme. Stafi akademik udhëheq studentët në tezat përfundimtare, gjatë punimeve shkencore nëse studentët marrin pjesë në konferenca.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Universiteti Epoka zhvillon mësimin në dy godina. Programi Bachelor në Financë-Bankë shqip zhvillon mësimin në klasat të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin e procesit mësimor. Ndërtimi i godinës së dytë shtoi ambjentet në përgjithësi. Në godinat e universitetit ka klasa për mësim, si dhe ambiente çlodhëse për studentët si mensë, kafeteri, bibliotekë, sallë interneti, mjedise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore, mjedise sportive etj.

Universiteti “Epoka” ka salla leksionesh dhe seminaresh të mjaftueshme. Universiteti ka 1 sallë konferencash në kampusin qendror. Universiteti “Epoka” ka në përbërje edhe një bibliotekë që është disponibël edhe për studentët e këtij program. Shërbimi bibliotekar ofrohet për stafin akademik dhe studentët. Studentët mund të studiojnë në bibliotekë. Gjithashtu, Universiteti posedon një kancelari, ku studentët marrin shërbime të ndryshme si psh. printime, fotokopjime, skanime etj. Në katin e parë gjendet mensa e cila është në shërbim të studentëve dhe të stafit.

Nga takimet me strukturat përkatëse gjatë vizitës në institucion u cilësua se Universiteti “Epoka” përdor shërbimet Google Apps for Education dhe pajis të gjithë studentët dhe stafin akademik dhe administrativ me adresë email-i në domain-in epoka.edu.al. Të gjitha informacionet dhe njoftimet e ndryshme zyrtare nga ana e Universitetit i komunikohen studentit ose stafit nëpërmjet kësaj adrese email-i. Me anë të kësaj adrese, studentet kanë akses në të gjitha shërbimet që ofron paketa Google Apps for Education.

Universiteti ofron zyra për personelin akademik, ku në një zyrë punon një ose dy pedagogë, së bashku me bibliotekën on line, ofrohen kështu kushte shumë të mira për punën e tyre shkencore. Sekretaria e studentëve është e ndarë nga ajo mësimore, me zyra të bollshme dhe me infrastrukturën e nevojshme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Standardi V.1 është plotësuar. Universiteti “Epoka” ka vënë në dispozicion të studentëve një numër të konsiderueshëm tekstesh bazë dhe literature ndihmëse e cila gjendet në mjediset e bibliotekës së Universitetit. Duke u bazuar tek kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë pasurohet në mënyrë periodike dhe vendoset në shërbim të studentëve. Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo	

<p>revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>përmbyjnë libra apo revista shkencore të nevojshme për kërkimin shkencor.</p> <p>Universiteti “Epoka” është i abonuar në bazën e të dhënave JSTOR e cila i mundëson stafit dhe studentëve të Universitetit aksesin në një gamë mjaft të gjerë të revistave shkencore. Përmes këtij fondi online, aksesin në mbi 2000 revista akademike të burimeve elektronike me tekst të plotë me cilësi të lartë është i disponueshëm pa pagesë për stafin, studentët dhe përdoruesit e bibliotekës. Si për stafin dhe për studentët janë disponibël edhe shumë burime të tjera elektronike si: Cambridge Journals Online, ScienceDirect, Emerald, IOPscience, Neë England Journal of Medicine, OECD-iLibrary, Taylor & Francis Library.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik, përgjegjësi i programit të studimit harton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit duke përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim. Titullarët e lëndëve bëjnë kërkesat e tyre në lidhje me nevojat për literaturë. Pas marrjes së miratimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, personeli i Bibliotekës procedon me blerjen e titujve të kërkuar nga ana e çdo Departamenti.</p> <p>Biblioteka pranon edhe dhurime të ndryshme. Oraret e punës të bibliotekës janë të shpallura në faqen web të Universitetit. Ato janë të shfaqura edhe në hyrje të bibliotekës, e cila është e hapur për studentët nga e hëna deri të premten nga ora 08:30 deri në 17:30 dhe të shtunën nga ora 09:00 deri në 13:00.</p> <p>Megjithatë Programi Bachelor në Financë-Bankë shqip që të arrijë objektivat e veta ka nevojë për më shumë literaturë të përditësuar dhe vecanërisht shqip. Literatura shqip është shumë e paktë, duhet të pasurohet.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbyjnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe</p>	<p>Standardi V.2 është plotësuar. Universiteti “Epoka” zotëron hapësiratë mjaftueshme dhe bashkëkohore, si: laboratorë, klasa, zyra, salla konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Gjithashtu, mjediset janë të kompletuara me sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike, etj.</p> <p>Për të përmbyshur nevojat e programeve të studimit, janë ngritur dy salla për seminarët e arkitekturës, dy laboratorë kompjuterikë, një laborator elektronik dhe laborator i</p>

<p>profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Inxhinierisë së Ndërtimit. Për të bërë të mundur një mësimdhënie sa më efektive dhe për t'u ardhur në ndihmë studentëve, universiteti ka instaluar një gamë të madhe programesh kopjuterike siç janë: Windows: MS Office, Autocad, Adobe, CodeBlocks, Visual Studio.Net, SPSS, etj..</p> <p>Në dy laboratorët disponibël gjenden nga 41 kompjutera secili (82 në total).</p> <p>Për programin e studimit në fjalë, lënda Ekonometri Financiare përdor laboratorët. Studentët në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë në Shqip nuk e kanë të detyruar kryerjen e praktikës profesionale.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Universiteti "Epoka" zotëron hapësira të mjaftueshme dhe bashkëkohore, si: laboratorë, klasa, zyra, salla konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Gjithashtu, mjediset janë të kompletuara me sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive (smart board), internet, etj.. Universiteti "Epoka" ka në mjediset e saj edhe bibliotekën e Universitetit. Literatura në bibliotekë shtohet në bazë të kërkesave të stafit akademik, kjo literaturë pasurohet në mënyrë periodike dhe vendoset në shërbim të studentëve. Universiteti "Epoka" është i abonuar në bazën e të dhënave JSTOR e cila i mundëson stafit dhe studentëve të Universitetit aksesin në një gamë mjaft të gjerë të revistave shkencore. Megjithatë Programi Bachelor në Financë-Bankë shqip që të arrijë objektivat e veta ka nevojë për më shumë literaturë të përditësuar dhe vecanërisht shqip. Literatura shqip është shumë e paktë, duhet të pasurohet.</p>	


5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve shkon për shpenzime në lidhje me tarifat për dhe gjatë shkollimit. Nga shqyrtimi financiar i kryer nga vetë Universiteti "EPOKA" rezulton se të ardhurat mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.846 euro, ndërsa shpenzimet mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.342 euro.

Të hyrat dhe të dalat e institucionit janë nën kontrollin e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a dhe administrohen në bashkëpunim me Zyrën e Financës të Universitetit EPOKA.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</p>	



<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Standardi II.5 është plotësuar. Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet pranë kësaj drejtorie. Pas përfundimit të raportit, Universiteti “Epoka” i referohet buxhetit të përgjithshëm të kompanisë si insitucion mëvartës. Raportet financiare të tre viteve të kaluara akademike janë të disponueshme në çdo kohë në Zyrën e Financës së Universitetit “Epoka” dhe në Zyrën e Financës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh.a, pjesë e së cilës është edhe Universiteti “Epoka”.</p> <p>Duke iu referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë e Universitetit “Epoka”.</p>
<p>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</p> <p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Standardi VI.1 është plotësuar. Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. bën një auditim të jashtëm për sa i përket situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., çdo vit. Në raportin e auditit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. dhe insitucionet mëvartëse.</p> <p>Në raport janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat si: grantet, tarifat studentore etj. dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte (nga kompani te tretë – outsourcing).</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Universiteti Epoka është pjesë e Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a.. Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të hyrat e këtij institucioni vijnë prej granteve për kërkim dhe kontratat, prej aktiviteteve tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) dhe tarifat për dhe gjatë shkollimit. Të ardhurat kryesore vijnë nga Tarifat e shkollimit. Pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve shkon për shpenzime në lidhje me tarifat për dhe gjatë shkollimit.</p> <p>Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. bën edhe një auditim të jashtëm vjetor për sa i përket situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të kësaj Shoqërie. Në raportin e auditit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. dhe insitucioneve të tjera në varësi.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Nga vizita në institucion dhe takimi me strukturat u konkludua se në Universitetin “Epoka” është ngritur Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë. Këshilli i Vlerësimit

Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) përbën njësinë qendrore të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin “Epoka”.

NJSBC kryen administrimin e të gjitha proceseve si dhe publikimin e rezultateve të vlerësimit të shërbimeve akademike dhe administrative, zhvillimin e cilësisë dhe miratimin e standardeve të cilësisë, të gjitha këto në përputhje me planin strategjik dhe qëllimet e Universitetit. Administrimin e proceseve në kuadër të vlerësimit të brendshëm në Universitet si dhe përgatitjen ose mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit, etj..

NJSBC administron procesin e anketave studentore. Studentët anketohen çdo fund semestri për pedagogët që kanë zhvilluar lëndët e semestrit.

Sipas RVB me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, sistemi elektronik nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog lënde me një shifër të përgjithshme si dhe shifër për çdo përbërës të pyetësorit, duke treguar renditjen e pedagogut të asaj lënde në rang departamenti dhe fakulteti. Rezultatet e pyetësorëve i përcillen Rektoratit nga Sekretaria Mësimore. Rektori, pasi shqyrton rezultatet e pyetësorëve, ia përcjell ato KVAZHC-së, i cili kryen analizimin e të dhënave për çdo lëndë dhe pedagog dhe del me rekomandimet përkatëse për Rektorin. Nëpërmjet mbledhjeve të Senatit, Rektori siguron që rekomandimet e KVAZHC-së në lidhje me përmirësimin e procesit të mësimdhënies të zbatohen në nivel Fakulteti dhe Departamenti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të 	<p>Standardi II.3 është plotësuar. Për përmirësimin e programeve të studimeve merren parasysh mendimet personelit akademik dhe të studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitetin “Epoka”, pas çdo rezultati të siguruar nga anketimi me studentë, bënë rivlerësimine brendisë së lëndës, nëbashkëpunim me departamentin.</p> <p>Nëse NJSBC i vjen një propozim për ndryshim kurrikule, bordi drejtues i NJSBC e miraton dhe më pas e drejton kërkesën në Senat për miratim përfundimtar. Procedura është vendosur me vendim Senati.</p> <p>Universiteti EPOKA përdor metodën e tërthortë:</p> <p>Përdor anketat me studentët. Rezultatet e anketave të studentëve bëhen të njohura për të gjithë.</p> <p>Universiteti EPOKA përdor edhe metodën e drejtpërdrejtë: Të dëgjimit në auditor</p>

<p>kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Standardi VIII.1 është plotësuar.</p> <p>Programet e studimeve përmirësohen duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. Anketa plotësohet nga të gjithë pasi është kusht plotësimi i tij për të marrë rezultatet e provimeve në system.</p> <p>Në anketë studenti pyetet mbi: korrektesën e pedagogut, cilësinë e leksioneve, cilësinë e komunikimit të pedagogut me studentët, etj..</p> <p>Departamenti i Finance-Bankes ka ndërtuar Planin Strategjik ku një nga fushat prioritare është tësigurohet një mjedis me cilësi të lartë për mësimdhënie dhe mësimnxënie</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre. Kështu për përmirësimin e programeve të studimeve merren parasysh mendimet personelit akademik dhe të studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitetin “Epoka”, pas çdo rezultati të siguruar nga anketimi me studentë, bënë rivlerësimin e brendisë së lëndës, në bashkëpunim me departamentin. Nëse NJSBC propozon ndryshim kurrikule, bordi drejtues i NJSBC e miraton dhe më pas e drejton kërkesën në Senat për miratim përfundimtar.</p> <p>Universiteti EPOKA përdor metodat e tërthorta dhe të drejtpërdrejta për vlerësimin e stafit akademik. Universiteti Përdor anketat me studentët. Asistentët pedagogë dëgjohe në auditor gjatë mësimit.</p> <p>Departamenti i Finance-Bankes ka ndërtuar Planin Strategjik ku një nga fushat prioritare është tësigurohet një mjedis me cilësi të lartë për mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Syllabuset që zhvillohen në këtë program në përgjithësi janë konform misionit dhe objektivit të programit. Planet mësimore janë të ndërtuar anë mënyrë të tillë që pasqyrojnë qartë temat, kreditet, dhe detyrimet e studentëve. Kreditet grumbullohen nga leksionet duke mos pasur kredite seminaresh apo praktike profesionale.

Syllabuset kanë edhe literaturën e cila me ndonjë përjashtim është në të gjitha lëndët. Literatura është e vjetër dhe në disa raste mungon fare literatura shqip(14 lëndë).

1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor përfshirë provimin. 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor përfshirë provimin, 14 javë mësim dhe dy javë konsultim dhe provim. Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë. Kreditet (ECTS) përfitohen nga studentët më tepër nga leksionet krahasuar me seminarët, dhe kryesisht nga puna e pavarur e studentëve. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që në përgjithësi zhvillohen 3 orë leksion në javë me nga 45 minuta.

- Për leksionet 1856 orënë auditor dhe 2580 orëpunë e pavarur e studentit
- Për Seminarët 64 orënë auditor dhe 11 orëpunë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 2_ orënë auditor dhe _18 orëpunë e pavarur e studentit

Në Planet mësimore të viti 2016-2017 ka ndryshime krahasuar me programet mësimore të licensuara të vitit 2012-2013. Në Tabelën 5, Aneksi 5, janë dhënë të detajuara. Janë 10 ndryshime në total por fakti që Bazat e Financave të Korporatave del dy herë në ndryshim sepse thjeshtë ka lëvizje nga semestri VI në të III, në thelb rezultojnë **9 ndryshime**. Nëse llogarisim ndryshimet me lëndë rezultojnë 26 përqind ndryshim, nëse llogarisim ndryshimet me kredite rezultojnë **25 përqind** ndryshim nga planet mësimore të licensuara.

Përgjatë vitit të II dhe të III, studentët kanë 6 lëndë me zgjedhje *5 ECTS = 30 ECTS, ndërkohë që Disiplinat me zgjedhje të studentit, ndërdisiplinat e ofruara nga institucioni të përcaktuara D duhet të jenë nga 12-14 kredite. Nëse institucioni do të përcaktonte kreditet në sajë të përgatitjes dhe kualifikimit profesional, ky problem do të shmangej. Në materialet e dorëzuara nga institucioni 4 lëndë me zgjedhje, janë përfshirë në disiplinat C, nëse i heqim këto lëndë me zgjedhje disiplinat D janë me 5 kredite.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Standardi I.1 është plotësuar. Institucioni ofron programe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në programi i studimit Bsc Finance- Banke shqip në çdo vit nga studentët përfitohen 60 kredite. Në total program ofron 180 kredite. Ajo që vihet re është unifikimi i ECTS të pothuaj gjithë lëndëve me 5, shumë pak janë me 6. Kreditet përfitohen nga Leksionet duke mos pasur kredite në seminare, praktikë profesionale apo laboratorë. Përveç leksioneve kredite përfitohen edhe nga Mikroteza apo Teza e diplomës.</p>
II ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>	<p>Standardi II.4 i plotësuar pjesërisht. Programi Bachelor në Financë-Bankë në Shqip ofrohet nga Departamenti i Financë-Bankes dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike</p>

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

dhe Administrative. Këto të fundit si njësi kryesore ku Programi Bachelor në Financë-Banke bën pjesë, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Ky informacion përmban edhe listën e të gjitha lëndëve të detyruara dhe me zgjedhje për çdo semestër, shoqëruar edhe me silabusin e detajuar për çdo lëndë. Silabusi i detajuar i çdo lënde, i cili është edhe i publikuar në faqen e internetit, përmban edhe ngarkesën mësimore, orët në auditor, orët në laborator, apo praktikë mësimore si dhe orët e studimit individual.

Si në faqen e internetit ashtu dhe në Guidën e Studentit shpjegohen në mënyrë të hollësishme edhe të gjitha rregullat në lidhje me frekuentimin, provimet, apelimet e notes si dhe të gjitha dispozitat që i interesojnë studentëve. Informacioni në fjalë mund të përfitohet gjithashtu nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e Departamentit.

Nga syllabuset vihet re një mungesë unifikimi në lidhje me numrin e testeve, ku një lëndë zhvillon 1 ndërkohë një tjetër edhe 4 të tilla.

Numri i shumë testeve vë në punë të vazhdueshme studentët por janë orë mësimi të pazhvilluara në ato lëndë që kanë shumë të tilla dhe nuk është e qartë nëse studentët përfitojnë apo thjesht humbasin orët e cmuara të mësimi.

Nga informacioni i përfituar rezultojnë se 3 lëndë nuk paraqisin fare literaturë në syllabus, ndërkohë që 16 të tjera kanë literaturën bazë anglisht nga të cilat 14 kanë vetëm literaturë anglisht (2 të tjerat kanë literaturë ndihmëse shqip), ndërkohë që për disa lëndë me zgjedhje nuk ka fare program.

Nga planet e licensuara deri në vitin aktual të studimit ka ndryshim të planeve mësimore me 25%. Ndryshimet që vihen re dhe nuk kanë lidhje me formimin profesional janë zëvendësimi i lëndëve të formimit ekonomik me lëndë me zgjedhje, ku shumë janë gjuhë të huaja.

Nëse student i zgjedh gjuhët e huaja të cdo viti atëherë ai mund të përfitojë rreth 45 ECTS me gjuhë të huaja duke cënuar formimin e tij profesional me mungesën e lëndëve profesionale. Nga takimi nga pedagogët na u tha se këshilluesi i studentëve i orienton që atë të mos zgjedhin aq shumë lëndë me

zgjedhje Gjuhë të huaja, megjithatë nuk na u tregua ndonjë rregullore në lidhje me këtë. Lëndët me zgjedhje mund të jenë më të shumta dhe më profesionale. Nga syllabuset vihet re një vendosje e lëndëve nga viti në vit jo sipas lidhjes formuese. Kështu Paraja dhe banka duhet të zhvillohet pas Bazave të financave të korporavate dhe makroekonomisë ku studentët marrin njohuri bazë të nevojshme. Studentëve ju mungojnë lëndë të profilit të financës si Fiskalitetet apo Financat personale. Ndërkohë që ka lëndë shumë të ngjashme që mund të bëhen njëose të jetë njëra me zgjedhje si; Hyrje në biznes dhe Menaxhimi dhe organizimi (janë lëndë menaxheriale jo financiare apo bankare), apo Legjislacioni i biznesit dhe Legjislacioni bankar, duke krijuar mundësinë e futjes së lëndëve më të profilizuara. Zhvillimi i vetëm leksioneve bënë që studentët të jenë së bashku pa ndarje në grupe të vogla, që do të ndikonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Konkluzionet e GVJ:

Institucioni ofron programe të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në programi i studimit Bsc Finance- Banke shqip në cdo vit nga studentët përfitohen 60 kredite. Në total program ofron 180 kredite.

Në faqen e internetit të Universitetit gjendet gjithë informacioni i nevojshëm për programin e studimit. Informacioni mund të përfitohet gjithashtu nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e Departamentit.

Syllabuset kanë informacion mbi pedagoget, leksionet, seminarët, pikët e fituara nga testet apo aktivizimet si dhe literaturën. Nuk ka unifikim në detyrime. Lëndët janë të ndryshme dhe ato ndryshojnë nga njëra tjetra megjithatë duhet të ketë disa maksimume apo minimume në lidhje me testet, detyrat e kursit, kolegiumet, etj. Literatura nuk ndodhet në planin mësimor të 3 lëndëve. Në përgjithësi literatura bazë është e huaj dhe në disa raste (14 lëndë) mungon fare literatura në shqip ndërkohë që ky program është në shqip.

Lëndët me zgjedhje në përgjithësi nuk janë lëndë profili, ndërkohë që ato duhet të profilizojnë studentin në përfundim të studimeve. Tek lëndët me zgjedhje dominojnë gjuhët e huaja dhe lëndë të formimit të përgjithshëm.

8. Mësimdhënia

Mësimdhënia në këtë program studimi sikurse në të gjithë Universitetin EPOKA, vlerësohet me anë të pyetësorëve apo anketës së studentëve. Studentët vlerësojnë mënyrën e shpjegimit, vlerësimin, komunikimin, korrektesën, etj. Mësimdhënia në përgjithësi jepet vetëm me Leksione, dhe kreditet merren po aty. Studentët vlerësohen me teste, detyra kurse, kolegiume dhe provim final, këto në varësi të lëndëve. Provimet përgjithësisht janë mbajtur në formë të shkruar. Megjithatë sipas RVB pedagogu i lëndës

mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë, me kusht që ai/ajo ta theksojë atë në formën e informacionit për lëndën (planit) brenda dy javëve pas fillimit të lëndës. Vlerësimi i studentëve në Universitetin "Epoka" bëhet në bazë të sistemit amerikan të krediteve dhe ECTS-së.

Orët e zhvilluara janë kryesisht leksione duke pasur shumë pak seminare dhe laboratore. Vlerësimi është i ndarë nëpërmjet testeve, aktivizimit dhe provimeve. Mungesa e disponueshmërisë së stafit ka bërë që oraret shpesh të mos jenë të përshtatshme për studentët. Kështu viti i tretë e zhvillon mësimin vetëm të premtën dhe të shtunën. Institucioni nuk i merr parasysh kërkesat e studentëve për oraret e studimit edhe në rastet kur ata kanë kërkuar ndryshime.

Studentët nuk kanë të detyrueshëm praktikën profesionale, por gjatë periudhës së verës angazhohen të mbështetur edhe nga stafi akademik në praktika dhe trajnime të ndryshme.

Sic u përmend edhe më parë për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitet e gjithë puna e stafit akademik vlerësohet nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut dhe vlerësimin e lëndës. Studentët mund të shprehin kënaqësinë ose pakënaqësinë e tyre në lidhje me kategoritë përkatëse duke ruajtur konfidencialitetin e plotë.

9. Studentët

Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me strukturat përkatëse universiteti synon tërheqjen e studentëve cilësorë dhe për këtë institucioni informon studentët në të gjithë shkollat e mesme të vendit në lidhje me programet që ofron, mundësitë e programit Erasmus, praktikat verore, konferencat, klubet studentore dhe bursat që ofrojnë për nxënësit më të mirë. Ky informim bëhet në periudhat e caktuara nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar nëpërmjet programit të Planifikimit të Karrierës.

Universiteti "Epoka" u ofron studentëve dhe të diplomuarve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar. Studentët e diplomuar kanë një notë mesatare 7. Nga rezultatet e viteve të kaluara rezultojnë që një pjesë e studentëve përfitojnë vende pune. Ky program ka nxjerrë vetëm dy breza studentësh të diplomuar, në total 23 studentë (i treti do të jetë këtë vit akademik). Institucioni disponon të dhëna për studentët nga momenti i pranimit deri në momentin e diplomimit, madje Zyra e Karrierës dhe Planifikimit ndjek ecurinë e tyre në treg edhe pas diplomimit. Nga të dhënat rezultojnë se rreth 90% e studentëve të diplomuar në këtë program, janë të punësuar ose vazhdojnë studimet master.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Standardi IV.1 është plotësuar. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka përfunduar me sukses

<p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>studimet e shkollës së mesme jashtë Shqipërisë dhe disponon vërtetimin e njësimi të kësaj diplome lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit së Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Universitetin Epoka.</p> <p>Kriteret e vecanta të Epokes për këtë program janë:</p> <p>Të ketë mesatare të Përgjithshme të Shkollës së Mesme mbi 6.00 ne programin e ofruar ne gjuhën Shqipe. Pikët e Provimit të Maturës Shtetërore</p> <p>Të ketë mjaftueshmëri të gjuhës Angleze të vërtetuar nëpërmjet një nga certifikatave të njohjes së gjuhës angleze nga Ministria e Arsimit dhe Spotit së Republikës së Shqipërisë.</p>
<p>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Standardi IV.2 është plotësuar.</p> <p>Institucioni në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron, mënyrën e organizimit të tyre si dhe kohëzgjatjen programeve të studimit. Në fillim të cdo viti akademik institucioni pajis cdo student me Udhëzuesin (Guidën) e Studentit e cila përmban informacionin e nevojshëm për jetën studentore. Në javën e parë të vitit akademik institucioni zhvillon javën e orientimit ku studentët janë të detyruar të ndjekin katër seksione gjatë të cilave informohen në mënyrë të detajuar.</p> <p>Puna e stafit akademik vlerësohet nga ana e studentëve në fund të çdo semestri me anë të një ankete, të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës.</p> <p>Universiteti "Epoka" u ofron studentëve dhe të diplomuarve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet "Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar". Zyra kryen aktivitete të ndryshme në kuadër të zhvillimit të karrierës së studentëve, si: Panairët e Punësimit, që është një aktivitet i përvitshëm ne universitet.</p> <p>Zyra e Planifikimit dhe Karrierës organizon Panairin e punësimit në muajin prill të çdo viti, ku në çdo panair marrin pjesë rreth 50 kompani të cilat operojnë në tregun vendas. Kjo zyrë ka lidhur marrëveshje me këto kompani. Përfaqësuesit e kompanive marrin në</p>

	<p>intervista punësimi studentët të cilët ndodhen në vitin e fundit. Nga rezultatet e viteve të kaluara rezulton që një pjesë e studentëve përfitojnë vende pune. Nga të dhënat rezulton se rreth 90% e studentëve të diplomuar në këtë program, janë të punësuar ose vazhdojnë studimet master.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve; Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Standardi IV.3 është plotësuar. Departamenti i Finance-Bankës disponon informacion në lidhje me studentët e diplomuar në këtë program studimi. Kështu ky program ka nxjerrë vetëm dy breza studentësh të diplomuar, në total 23 studentë (i treti do të jetë këtë vit akademik). Institucioni disponon të dhëna për studentët nga momenti i pranimit deri në momentin e diplomimit, madje Zyra e Karrieres dhe Planifikimit ndjek ecurinë e tyre në treg edhe pas diplomimit.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Standardi IV.4 është plotësuar. Këshillimi i studentëve bëhet gjatë gjithë studimeve. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar, ndjek progresin e studentëve në procesin mësimor. Në këtë kuadër kjo zyrë ofron programin e "Mentorimit". Duke ofruar këtë program studentët në nevojë marrin këshillime nga studentët më të mëdhenj të cilët janë përfitues të programit të bursave në universitetin Epoka, u vijnë në ndihmë studentëve në fjalë në lëndë përkatëse. Pedagogët janë disponibël dhe të motivuar për të ndihmuar studentët të zgjedhin lëndët me zgjedhje dhe kompanitë që do të kryejnë praktikën. Praktika profesionale do të duhej të ishte e detyrueshme meqenëse nuk është për këtë program studimi.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga Universiteti "Epoka", bëhet sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Institucioni në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron, mënyrën e organizimit të tyre si dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Universiteti "Epoka" u ofron studentëve dhe të diplomuarve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet "Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar".</p>	

Zyra e Planifikimit dhe Karrierës organizon Panairin e punësimit në muajin prill të çdo viti, ku në çdo panair marrin pjesë rreth 50 kompani të cilat operojnë në tregun vendas. Nga të dhënat rezulton se rreth 90% e studentëve të diplomuar në këtë program, janë të punësuar ose vazhdojnë studimet master.

Institucioni disponon të dhëna për studentët nga momenti i pranimin deri në momentin e diplomimit, madje Zyra e Karrierës dhe Planifikimit ndjek ecurinë e tyre në treg edhe pas diplomimit. Këshillimi i studentëve bëhet gjatë gjithë studimeve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm stafi është i motivuar për kërkime shkencore dhe avancim karriere. Pedagogët e departamentit Financë-Bankë janë pjesë aktive mes stafit të universitetit, duke pasur shumë publikime në konferenca ndërkombëtare dhe punime shkencore në revista shkencore me faktor impakti. Universiteti EPOKA është pjesëmarrëse në disa projekte ku ka të përfshirë edhe pedagogë të Departamentit të Financës. Departamenti nuk është pjesë e ndonjë projekti por stafi nga ana e vet avancohet në kërkimet shkencore në aktivitete shkencore si dhe në hulumtime shkencore për tezat e doktoraturave.

Universiteti EPOKA organizon disa konferenca ndërkombëtare. Stafi akademik është mjaft aktiv, kjo tregohet edhe nga numri i punimeve shkencore pjesëmarrës në konferenca të organizuara nga Universiteti EPOKA ose të organizuara nga institucione të tjera.

Departamenti Finance-Bankë nuk organizon vet Konferencë kombëtare apo ndërkombëtare por nxit studentët dhe i përfshin ata të jenë pjesë e punimeve shkencore të pedagogëve duke ju dhënë kështu edhe eksperiencën e punimeve shkencore, janë 20 punime në bashkëpunim. Gjithashtu krijohen panele debatesh për çështje të caktuara ekonomike.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Universiteti "Epoka" ka nënshkruar 31 marrëveshje dypaleshe me universitete të ndryshme për të mundësuar shkëmbime stafi dhe studentësh, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore.

Sic e përmendëm më sipër Departamenti Financë- Bankë nuk është pjesë e ndonjë projekti. Institucioni ofron infrastrukturën e nevojshme për kërkim shkencor. Biblioteka përveç literaturave që zotëron ofron mundësinë e kërkimit shkencor prej aksesit në shumë revista.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Standardi VII.1 është plotësuar. Universiteti “Epoka” nxit frymën e bashkëpunimit ndërmjet stafit të universitetit duke i inkurajuar ata që të bëhen pjesë e projekteve të ndryshme ose të bëjnë kërkime shkencore në bashkëpunim me njëri tjetrin.</p> <p>Kompetencat dhe ndarja e detyrave të personelit janë parashikuar në Rregulloren e Organizimit Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësiive përkatëse dhe analizën e vazhdueshme të punës së tyre si dhe garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>
<p>Standardi VII.2 Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Standardi VII.1 është plotësuar. Universiteti “Epoka” në bashkëpunim me njësitë e veta funksionale studion tregun dhe ndjek një strategji të hapur për bashkëpunim dhe partneritet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij.</p> <p>Me institucionet e huaja arsimore që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, Universiteti Epoka, mundëson bashkëpunim të personelit akademik dhe të studentëve, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore.</p> <p>Veçanërisht gjatë verës, studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika mësimore në formë stazhi. Universiteti “Epoka” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve. Për këtë arsye, janë nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi me institucione të ndryshme brënda dhe jashtë vendit.</p> <p>Sipas këtyre marrëveshjeve, studentët e Universiteti “Epoka” përfitojnë nga mundësitë e praktikave të ofruara nga këto kompani. Universiteti “Epoka” duke u bazuar në Deklaratën e Bolonjës, nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm.</p> <p>Universiteti Epoka, prej një periudhe 5-vjeçare i jep mundësinë studentëve dhe stafit akademik të marrin pjesë në programet e shkëmbimit në kuadrin e Marrëveshjeve Dypalëshe, Programit të Shkëmbimit Mevlana dhe Programit të Shkëmbimit Erasmus+.</p> <p>Universiteti Epoka, numeron 31 marrëveshje dypalëshe me universitete të ndryshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Itali, Spanjë, Estoni, Zvicër, Rumani, Poloni, Turqi etj.</p>

Konkluzionet e GVJ

Universiteti "Epoka" ka nënshkruar 31 marrëveshje dypaleshe me universitete të ndryshme për të mundësuar shkëmbime stafi dhe studentësh, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore. Universiteti "Epoka" siguron mundësi të shumta për kryerjen e praktikave nga ana e studentëve, veçanërisht gjatë sezonit të verës, nëpërmjet marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit të nënshkruara me institucione dhe kompani brenda dhe jashtë vendit (ky program nuk ka praktikë profesionale të detyrueshme).

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Eshtë plotësuar pjesërisht rekomandimi:

- Të pasurohet literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe të bëhet një bashkërendim më i mirë ndërmjet njohurive nga eksperiencia botërore me ato që kanë të bëjnë me realitetin e ekonomisë shqiptare. Pothuaj mungon literature shqip.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Studentë të motivuar
- 2) Përdorimi i literaturës bashkëkohore
- 3) Laboratorët që përdoren në procesin e mësimdhënies
- 4) Infrastruktura e sallave në tërësi lehtëson procesin e mësimin
- 5) Zyrat e stafit janë komode dhe lehtësojnë kërkimin shkencor
- 6) Biblioteka dhe aksesit në informacionet nga burimet elektronike.
- 7) Marrëdhënia dhe komunikimi pedagoge-student
- 8) Organizimi i kurrikulave, programeve dhe lëndëve sipas sistemit të Bolonjës (ECTS) dhe sistemit Amerikan të krediteve.
- 9) Marrëdhënie të ngushta me punëdhënësit dhe stafit ndërmjet tyre (panaire, internshipe, etj)
- 10) Marrëdhënie të institucionalizuara me universitetet e huaja
- 11) Imazhi publik

b. Pika të dobëta:

- 1) Stafit relativisht i ri, duke pasur mungesa gradash dhe eksperiencë
- 2) Praktika profesionale nuk është e detyrueshme
- 3) Numri i pedagogëve të brendshëm është i ulët ku kemi parasysh se i njëjti departamenti ofron si programin Finance-Bankë shqip edhe atë në gjuhë anglisht.
- 4) Bibliotekë e varfër me literaturë në shqip.

- 5) Në programet mësimore të shumë lëndëve mungon literatura shqip. Kjo sjell probleme me cilësinë e mësimdhënies, ndërkohë që programi i studimit është shqip dhe studentët nuk janë shumë mirë me gjuhën angleze.
- 6) Mungesa e ndarjes së qartë të leksioneve dhe seminareve
- 7) Orët e mësimi në përgjithësi janë 3 orë në javë me 45 minuta, të pamjaftueshme për mësimnxënie cilësore.
- 8) Lëndët me zgjedhje janë shume dhe jo të përshtatshme. Këto të fundit nuk ofrojnë profil të qartë finance apo banke, shumë prej tyre janë gjuhë e huaj.

c. Mundësitë:

- 1) Departamenti i financës mund të përfshihet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare
- 2) Mund të ndryshojë kurrikula duke vendosur një rrjedhë më profesionale të lëndëve nga viti në vit, për të rritur kompetencat fituara dhe përgjigjur kërkesës së tregut
- 3) Mund të shtohen pikët e aktivizimit të studentëve, për ti motivuar ata.
- 4) Marrëveshjet me universitetet e huaja mund të shfrytëzohen nga studentët shqiptarë për të studiuar në universitetet e njohura.
- 5) Eksperienca në mësimdhënie që mund të përfitohet nga stafi në saj të marrëveshjeve ndëruniversitare
- 6) Trajnime të stafit në fusha të caktuara që ata mbulojnë apo janë titullarë
- 7) Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet e tjera private dhe publike
- 8) Disponibiliteti i lektorëve dhe asistentëve në çdo kohë (viti i tretë zhvillon mësim vetëm të premtë dhe të shtunë për mungesë të disponibilitetit të lektorëve)

d. Pengesat:

1. Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga një pjesë e stafit të huaj dhe vecanërisht nga nivelet drejtuese duke penguar komunikimin e tyre me studentët dhe pedagogët shqiptarë (programi është në shqip)
2. Numri i lartë i universiteteve në Shqipëri që ofrojnë këtë program
3. Rreziku i humbjes së një pjese të stafit si pasojë e konkurrencës
4. Largësia nga Tirana duke u parë si kosto shtesë për studentët

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof.asoc. Dr Etleva BAJRAMI

